



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M  
Nr. 325, datë 25.10.2021

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT  
PËR PROKUROREN ORNELA RRUMBULLAKU

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 189, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 8, të Rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr.64 datë 15.04.2019, pasi u njoh me kërkesën me nr. Prot 614, datë 01.10.2021 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren znj. Ornela Rrumbullaku, si pedagoge me kohë të pjesshme, për lëndën “E drejta procedurale penale”, për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022 pranë Universitetit EPOKA, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, me ngarkesa mësimore 2 orë në javë brenda orarit zyrtar të punës dhe 2 orë në javë jashtë orarit zyrtar të punës.
2. Të njoftohen për këtë vendim znj. Ornela Rrumbullaku dhe Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA



SEKRETA

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI



ANËTAR  
BUJAR SHESHI



ANËTAR  
NURIHAN SEITI



ANËTAR  
ELOIDA GOXHI



ANËTAR  
ESMERALDA KESHI



ANËTAR  
MOISI DUDA



ANËTAR  
VATË STAKA



ANËTAR  
SANDËR BECI



ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

